



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



ZYRA E PROKURIMIT

Nr. 282021

Nr. Protokolli: 40/2021

Për:	Furnizim me kamera të sigurisë për shkolla
Kopje:	z.Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës
Nga:	Afrim BYTYQI, u.d. Shef i Prokurimit
Lënda:	VENDIM
Datë:	20.04.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 19.04.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **K.S. Besa Security Sh.P.K**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Furnizim me kamera të sigurisë për shkolla**” me Nr. të Prokurimi: **624-21-1799-1-2-1 & 624-21-077-1-2-1** nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Hedhet Poshtë si e pas afatshme kërkesa për ri-shqyrtim e datës 19.04.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “K.S. Besa Security Sh.P.K”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me kamera të sigurisë për shkolla ” me Nr. të Prokurimi: **624-21-1799-1-2-1 & 624-21-077-1-2-1**.
- II. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë 19.04.2021 ka pranuar kërkesë për ri-shqyrtim nga Operatori Ekonomik “ K.S. Besa Security Sh.P.K”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me kamera të sigurisë për shkolla” me Nr. të Prokurimi: 624-21-1799-1-2-1 & 624-21-077-1-2-1, për kriteret e vendosuara nga AK.

Kërkesa për ri-shqyrtim është paraqitur pas afatit të paraparë me dispozita ligjore, konkretisht me nenin 4, paragrafi 4.1 tek Rregullat për Parashtrim të Ankesave të nxjerruar nga KRPP. Kjo pasi që hapja e tenderit është me date 23.04.2021 ndërsa ju keni parashtruar kerkesen me date 19.04.2021.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

u.d. Shef i Prokurimit
Afrim BYTYQI

